

**AKT - THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE " BARDHI H & B ,, SH.P.K.**

Sot, me date 22.02.2006 une , Fatbardh Plangaj i biri i Halil dhe Xhevahire i dtl 13.3.1974 banues ne l. K.permetit rr. I.Sokoli p.1300 Shkoder,ne mbeshtetje te ligjit nr 7512 date 10.8.1991 dhe ligjit nr 7638 date 19.11.1992 dhe ligjit nr 7667 date 28.01.1993,vendosa krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar " BARDHI H & B ,, (Ku inicialet H- B jane germat e para te fjaleve Health dhe Beauty) ,me ortak te vetem , mua Fatbardh Plangaj .

**NENI 2**

Selia e Sh.p.k. " BARDHI H & B ,, do te jete ne qytetin e Shkodres ,I.F.Ramadani rr.Çlirimi pallati tetekatesh Shkoder.

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar" BARDHI H & B ,, SH.P.K. SHKODER eshte:**

**" tregtim medikamentesh farmaceutike, kozmetike, aksesor higjenosanitar, ushqime per femije, artikuj ortopedike, paisje per paraplegjike dhe invalide,produkte dietetike,syze optike, eksport –import dhe trajtime estetike, sallon nuserie, bar - bufe .**

**NENI 4**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe eshte kontribut i ortakut te vetem te shoqerise,themeluesit te saj,Z.Fatbardh Plangaj.  
Per te saktësuar veprimtarine e vet ekonomike si dhe marrdhenjet e punes, shoqeria do te cele e do te mbaje librin e vet qe quhet"libri i shoqerise,,  
Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " BARDHI H & B ,, SH.P.K. Shkoder do te mbaje llogarine e saj duke u mbeshtetur tek leku shqipetar dhe valutat e huaja.  
Maredheniet e punes ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punes.Per ceshtje qe nuk rregullohen nga kontrata e punes, shoqeria do te bazohet ne legjislacionin ne fuqi me vendim te ortakut te vetem te saj.  
E njejta gje vlen edhe per zyrat.filiale,deget e dyta ose agjensite.

**NENI 5**

Kohe – zgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte mbi 10 vjet . Ajo mund te shperndahet me vendim te ortakut te vetem te shoqerise ose me vendim te personave

te autorizuar prej tij me prokure te posacme per shperndarjen e shoqerise,ose kur shperndarjen e saj e percakton legjislacioni ne fuqi..

NENI 6


Sh.p.k. " BARDHI H & B ,, Shkoder do te perfaqesohet nga ortaku i vetem i shoqerise,  
Z.Fatbardh Plangaj si dhe persona te tjere te autorizuar prej tij me prokure te posacme.

NENI 7

Ndryshimet ne kete akt themelimi do te behen me te njejten procedure qe u ndjek per vete aktin e themelimit.

Akt - themelimi u nenshkrua rregullisht nga ortaku i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar" BARDHI H & B ,, SH.P.K.Shkoder,Z.Fatbardh Plangaj .

FATBARDH PLANGAJ



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE SHKODER

NR REP 112  
NR KOI. 50

### AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me dt 22.02.2006 ditën e merkure ne zyren e noterise Shkoder dhe para meje noteres se kesaj zyre Anila Dibra u paraqit personalisht Fatbardh Plangaj i biri i Halil dhe Xhevahire i dtl 13.3.1974 banues ne l. K.permetit rr. I.Sokoli p.1300 Shkoder.,titullar i pasaportes me numer Z 1744777 per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te dokumenteve te tij te identifikimit dhe pasi konstatova se i ka te gjitha aftesite e kerkuara nga ligji-madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,dhe me deshiren e tij te plote pasi i lexova kete akt themelimi, i cili u gjet konform kerkimit dhe vullnetit te tij te plote dhe une si notere i vertetova nenshkrimin.

NOTERE  
ANILA DIBRA



# STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BARDHI H & B ,,"

## FORMIMI

### NENI 1

Ne baze te ligjit nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones tregtare e te privatizimit,,te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare,, dhe ligjit nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregtar me vullnetin e tij te lire, te shprehur ne nenshkrimet e aktit te themelimit qe i bashkohet ketij statuti:

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " BARDHI H & B ,(Ku inicialet H- B jane gerrat e para te fjaleve Health dhe Beauty) me ortak te vetem Z.Fatbardh Plangaj i biri i Halil dhe Xhevahire i dtl 13.03.1974 banues ne I. K.Permetit rr. I.Sokoli p.1300 Shkoder.TEL.0224 7689.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " BARDHI H & B ,,Sh.p.k. Shkoder,fiton zotesine per te vepruar nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregtar ne gjykatën e rrethit Tirane,ndersa ushtron aktivitetin e saj ekonomik me regjistrimin e saj ne organin perkates tatimor te pushtetit.Ajo eshte person juridik dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi,dhe te akteve te saj themeluese si ky statut dhe aktit te themelimit qe i bashkohet dhe perben nje pjese te pandare te saj.

## SELIA

### NENI 2

Selia e shoqerise " BARDHI H & B ,, SH.P.K. Shkoder do te jete ne qytetin e Shkodres lagja "F.Ramadani rr. Çlirimi pallati tetekatesh Shkoder.  
Shoqeria mund te hape edhe vend-qendrim te tjera te dyta,operative,perfaqesi dhe agjensi ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise dhe jashte saj ,me miratimin e organeve kompetente ne perputhje me legjislacionin e vendit ku ato hapen.

## OBJEKTI

### NENI 3

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar”  
BARDHI H & B „ SH.P.K. SHKODER eshte:  
“ tregtim medikamentesh farmaceutike, kozmetike, aksesor higjenosanitar,  
ushqime per femije, artikuj ortopedike, paisje per paraplegjike dhe  
invalidë, produkte dietetike, syze optike, eksport –import dhe trajtime estetike,  
sallon nuserie, bar - bufe .

## KOHE ZGJATJA

### NENI 4

Kohe – zgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte mbi 10 vjet . Ajo mund te shperndahet me vendim te ortakut te vetem te shoqerise ose me vendim te personave te autorizuar prej tij me prokure te posacme per shperndarjen e shoqerise,ose kur shperndarjen e saj e percakton legjislacioni ne fuqi..

### NENI 5

SH.P.K. “ BARDHI H & B „ Shkoder,mund te ndryshoje emertimin,seline dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre ortakut i vetem i shoqerise Z.Fatbardh Plangaj.

## KAPITALI THEMELTAR

### NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise “ BARDHI H & B „Sh.p.k. Shkoder eshte 100.000 leke,dhe eshte kontribut i ortakut te vetem Z.Fatbardh Plangaj .  
Kapitali themeltar mund te shtohet me deshiren dhe sipas vendimeve qe do te marre ortakut i vetem i shoqerise Z.Fatbardh Plangaj.  
Kapitali themeltar ose pjese te tij mund te transferohen ose te lihen peng ne perputhje me ligjet ne fuqi,duke u vertetuar me nje akt noterial.  
Kapitali themeltar mund te transferohet ne rruge trashegimie.  
Bashkshorti,paraardhesit ose pasardhesit e ortakut te vetem mund te behen ortake te shoqerise nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar.

Pjeset e kapitali themeltar te shoqerise mund te transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese si ortake te shoqerise vetem me miratimin e ortakut te vetem te shoqerise Z.Fatbardh Plangaj.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

### NENI 7

Shoqëria " BARDHI H & B ,, Sh.p.k.Shkoder është prone e themeluesit të saj, ortakut të vetëm Z.Fatbardh Plangaj ,i cili është edhe organi vendimor i shoqërisë,dhe ka të drejtën e zgjedhjes së administratorëve që do të hyjnë në marrëdhënie me të tretët.

Administrator i shoqërisë do të jetë Z.Fatbardh Plangaj.

Ortaku i vetëm i shoqërisë thërret mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të shoqërisë.

Në mbledhjet e zakonshme ai shqyrton dhe vendos për çështje të tilla si emerim e shkarkim të personave të punësuar në këtë shoqëri dhe analizën e gjithë aktivitetit të shoqërisë deri në ndarjen e fitimit.

Në mbledhjet e jashtëzakonshme ai shqyrton dhe vendos për çështje të tilla si ndryshim statuti,zvogelim të kapitalit themeltar,shtimin e kapitalit themeltar,zgjatjen ose zvogelimin e kohës së veprimtarisë ose likuidimit të saj.

## N E N I 8

Në emër të shoqërisë administratori ka këto kompetenca:

- Te marrë pjesë në ankandë
- Te përpilojë kontrata të çdo lloji qofshin ato dhe akte të tjera juridike që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë,
- Te hapë llogari rrjedhese bankare në Bankën Shqiptare brenda dhe jashtë vendit.
- Te përfaqësojë shoqërinë në të gjitha strukturat shtetërore dhe gjyqësore në të gjitha shkallët dhe të çfarëdo lloji qofshin ato.
- Te kryejë veprime të ndryshme që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

## N E N I 9

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " BARDHI H & B ,, ka një administrator,- ortakun e vetëm Z.Fatbardh Plangaj-por kjo nuk pengon që në të ardhmen me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë,numri i tyre të ndryshojë duke bazuar edhe në ligj.

## N E N I 10

Administratori është përgjegjës para shoqërisë dhe të tremeve si për shkeljet ligjore,shkeljet e statutit ose për fajet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

## N E N I 11

Shoqëria ka vullnet të saj me përmbajtje SH.P.K. " BARDHI H & B ,, Shkoder.Te drejtën e përdorimit të vullnetit të krijuar i shoqërisë,ortaku i saj i vetëm Z.Fatbardh Plangaj, si dhe personat e autorizuar nga ortakut i vetëm.

## MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

## N E N I 12

Marredheniet e punes rregullohen nga kontratat e punes qe lidhen midis perfaqesuesit te shoqerise dhe personit te punesuar ne kete shoqeri. Mosmarreveshjet ndermjet paleve zgjidhen me mirekuptim, ne rast te kundert i drejtohen organit kompetent te percaktuar ne kontraten e punes.

### N E N I 13

Ortaku i vetem percakton administratorin dhe punonjesit e tjere te cileve i u cakton pagat dhe detyrat.

Shoqeria respekton rregullat e punesimit dhe te sigurimeve shoqerore, kurse te punesuarit jane te detyruar te pranojne dhe zbatojne normat e ketij statuti. Administratori i emeruar nuk mund te marre cilesine e ortakut te vetem te shoqerise dhe as te zhvilloje aktivitet kontraktor te cfare cdo lloji per llogari te tij.

### N E N I 14

Te gjitha te punesuarit ne kete shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se shoqerise gjate dhe ne rastet e largimit nga puna. Sekret pune paraqesin shkresat materiale, si dhe aktet te cilat me ligj, me dispozita te vecanta apo me vendime te ortakut te vetem te shoqerise, jane shpallur sekret pune, te dhenat informative, bilancet, plane dhe informacione per politiken ekonomike te shoqerise qe u jepen organeve kompetente perkatese te miratuara nga ortaku i vetem i shoqerise.

## PERFAQESIMI I SHOQERISE

### N E N I 15

Perfaqesimi i shoqerise " BARDHI H & B ,, SH.P.K. i perket ortakut te vetem te saj, dhe administratorit te autorizuar prej tij. Ai ka te drejte ta perfaqsoje shoqerine edhe ne organet gjyqsore dhe ne gjykime, te caktoje dhe te pushoje avokate per ceshtje ne gjykim.

E gjitha veprimtaria ekonomike e shoqerise drejtohet nga ortaku i vetem i saj Z. Fatbardh Plangaj i cili vendos per pjesmarrjen e shoqerise ne shoqerite e tjera, te ndryshoje ose te plotesoje statutin e shoqerise, te miratoje bilancet vjetore dhe periodike te vleresuara nga organi i saj financiar, te vendose per shperberjen e shoqerise, te percaktoje politiken ekonomike ne fushat e zhvillimit te veprimtarise se saj.

## EKSPERTI KONTABEL

### N E N I 16

Ortaku i vetem Z.Fatbardh Plangaj mund te caktojë edhe ekspert kontabel, te cilet kontrollojnë veprimtarinë financiare, arken e regjistrin e veprimeve kontabel dhe te pergatisin raportin perkates te shoqerise.

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

### NENI 17

Shoqeria " BARDHI H & B „Sh.p.k. Shkoder, cele llogarine e saj rrjedhese ne Banka ne Shqiperi. Veprimet ekonomike te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor. Ne fund te cdo periudhe nxirret bilanci kontabel prej ekspertit kontabel, qe miratohet nga ortaku i vetem i shoqerise.

Te ardhurat neto, pas vecimit te fondeve te nevojshme i mbeten ortakut te vetem te shoqerise e cila ndahet per zgjerimin e kapitalit te shoqerise, se dyti per fondet e shoqerise dhe se treti per ortakun e vetem.

## FONDET E SHOQERISE

### NENI 18

Shoqeria percakton fondet sime poshte:

a- Fondi themeltar

b- Fondi rezerve

c- Fonde te tjera te cilat mund te jene te nevojshme per realizimin e veprimtarise se saj.

Masa e secilit fond dhe menyra e perdorimit te saj percaktohen nga ortaku i vetem i shoqerise.

## CMIMET

### NENI 19

Aktivitetin e saj shoqeria " BARDHI H & B „Sh.p.k. Shkoder e zhvillon kundrejt cmimeve sipas kerkeses dhe ofertes, me perjashtim te rasteve te percaktuara me vendim qeverie.

## SHPERBERJA E SHOQERISE

### NENI 20

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, si per humbje te kapitalit te shoqerise, pamundesi veprimtarie me vendim me shkrim te ortakut te vetem te shoqerise.

### NENI 21

Me shperberjen e shoqerise caktohen nje ose disa likujdatore,duke iu caktuar edhe detyra konkrete,ne radhe te pare per likujdimin e personave te trete duke percaktuar edhe burimet e likujdimit.


NENI 22

Persa nuk eshte shprehur ne statut i referohet plotesimeve qe do te beje ortaku i vetem i shoqerise ne baze te ligjeve ekzistuese e te ligjeve e akteve nenligjore qe do te dalin.

NENI 23

Ky statut u firmos nga themelusi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " BARDHI H & B ,, SH.P.K. Shkoder Fatbardh Plangaj.

FATBARDH PLANGAJ



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE SHKODER

NR REP 113  
NR KOI 51

### AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me dt 22.02.2006 ditën e merkure ne zyren e noterise Shkoder dhe para meje noteres se kesaj zyre Anila Dibra u paraqit personalisht Fatbardh Plangaj i biri i Halil dhe Xhevahire i dtl 13.3.1974 banues ne l. K.permetit rr. I.Sokoli p.1300 Shkoder.,titullar i pasaportes me numer Z 1744777 per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te dokumenteve te tij te identifikimit dhe pasi konstatova se i ka te gjitha aftesite e kerkuara nga ligji-madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,dhe me deshiren e tij te plote pasi i lexova kete statut. i cili u gjet konform kerkimit dhe vullnetit te tij te plote dhe une si notere i vertetova nenshkrimin.

NOTERE  
ANILA DIBRA